



FEDERATA SHQIPTARE E PESHKIMIT SPORTIV

RREGULLORE E BRENDSHME E FUNKSIONIMIT TE FSHPS

V 2024

Neni 1 – OBJEKTI I RREGULLORES

Objekti i kesaj rregullore eshte caktimi i rregullave te hollesishme normative lidhur me funksionimin normal te Federates Shqiptare te Peshkimit Sportiv, te cilat konsistojne kryesisht ne:

- Organet Drejtuese dhe funksionimi i tyre
- Gjyqtaret dhe Komisaret e Garave
- Klubet dhe antaresia e FSHPS
- Teknikat e Peshkimit Sportiv dhe Garat
- Buxheti vjetor i FSHPS
- Sponsorizimet
- Website dhe publikimet zyrtare te FSHPS

NENI 2 – ORGANET DREJTUESE DHE FUNKSIONIMI I TYRE

1. Asambleja e Pergjithshme
2. Presidenti
3. Zv. Presidenti
4. Komiteti Drejtues
5. Sekretari i Pergjithshem

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i FSHPS. Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese jane te percaktuara ne Statutin e FSHPS.

Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme behet nga Sekretari i Pergjithshem ne nje nga format e meposhtme:

1. Njoftim nepermjet grupit ne Whatsapp (FSHPS – NJOFTIME)
2. Njoftim me Poste Rekomande
3. Njoftim ne faqen zyrtare te FSHPS www.fshps.org

Ne mungese te zyrove te FSHPS, KD gjen nje ambient te pershtatshem per mbledhjet e Asamblese. Shpenzimet e mbledhjes se Asamblese paguhen nga buxheti vjetor i FSHPS.

Komiteti Drejtues perbehet nga pese anetare, kopetencat dhe detyrat e KD percaktohen ne Statutin e FSHPS.

KD duhet te mblidhet cdo muaj, perkatesisht ne te enjten e fundit te cdo muaji. Ne mungese te zyres se FSHPS, KD gjen nje ambient te pershtatshem per mbledhjet dhe shpenzimet e mbledhjes paguhen nga buxheti vjetor i FSHPS.

Ne raste urgjente dhe ne pamundesi takimi, KD mund te mblidhet Online dhe te marre vendime. Ne takimet online duhet te jete prezent edhe Presidenti ose Zv. Presidenti dhe Sekretari i Pergjithshem. Vendimet e KD zbardhen nga Sekretari i Pergjithshem brenda

5 diteve dhe publikohen ne faqen zyrtare te FSHPS www.fshps.org, gjithashtu nje kopje vendimi dergohet edhe ne grupin e whatsapp (FSHPS – Njoftime).

Ne rast se nje anetar i KD mungon pa arsye ne tre mbledhje te njepasnjeshme te KD, atehere ky anetar e humbet mandatin dhe KD shpall vendin vakant per te plotesuar Komitetin Drejtues me pese anetare.

NENI 3 – GJYQTARET DHE KOMISARET E GARAVE

Gjyqtaria dhe Komisaret e Garave jane organ i pavarur i FSHPS. KD perpilon dhe miraton rregulloret e garave dhe mbi to gjyqtaret dhe komisarët e garave gjykojne dhe referojne garat e organizuara nga FSHPS.

KD organizon trajnimin dhe me pas certifikimin e gjyqtareve sportive dhe komisareve te garave. Vetem pas certifikimit nga FSHPS nje gjyqtar eshte i afte te gjykoje nje gare.

Komisaret e garave jane persona qe kane njohuri mbi procedurat e zhvillimit te gares, llojit te peshqve dhe matjes se tyre.

Qe nje gare te jete e vlefshme duhet te kete patjeter nje gjyqtar te certifikuar nga FSHPS. Drejtori i gares vendos per numrin e gjyqtareve dhe komisareve te gares qe do te referojne nje gare, kjo ne varesi te numrit te pjesemarresve.

Per garat ne tekniken Surfcasting, raporti i komisareve duhet te jete 1 komisar per maksimumi 10 garues dhe 1 gjyqtar per maksimumi 30 garues.

Per garat e peshkimit me tape duhet te kete te pakten nje gjyqtar dhe nje komisar gare.

Per garat e peshkimit nga varka duhet te kete nje gjyqtar per cdo varke i cili shoqeron garuesit gjate zhvillimit te gares dhe nje komisar qe ndihmon ne peshimin e peshqve pas perfundimit te gares.

Per garat e hedhjes teknike Longcasting duhet te kete te pakten nje gjyqtar dhe nje komisar gare.

Klubet anetare te FSHPS te cilat organizojne garat e peshkimit sportiv sipas kalendarit te paraqitur me pare dhe te miratuar nga KD jane te detyruara qe te marrin per gjykim vetem gjyqtaret e certifikuar nga FSHPS.

Kuota per gjyqtarin e gares nuk duhet te jete nen 5000 Lek per gare dhe per komisarin e gares nen 3000 Lek.

Klubet dhe anetaret e FSHPS duhet te dorezojne prane sekretariatit te FSHPS kandidatet per te ndjekur kursin dhe certifikimin e gjyqtarise sportive. FSHPS simulon nepermjet organizimit te nje “Dite Peshkimi” situata te ndryshme per menyren se si organizohet nje gare peshkimi per tu mundesuar komisareve te gares dhe gjyqtareve te

perballen me situatat e mundshme ne nje gare peshkimi. Me pas FSHPS certifikon Gjyqtaret dhe Komisaret e Gares.

Kurset per trajnimin dhe certifikimin e Gjyqtarise Sportive dhe komisareve te garave organizohet cdo vit sipas nje plani te hartuar nga KD i cili publikohet ne faqen zyrtare te FSHPS.

Kosto e organizimit te kurseve trajnuese do te mbulohet nga buxheti vjetor i FSHPS.

NENI 4 - KLUBET DHE ANETARESIA E FSHPS

Anetaresia e FSHPS rregullohet sipas Statutit te FSHPS. Cdo anetar i FSHPS eshte i detyruar te zbatoje Statutin e FSHPS si dhe kete Rregullore te Brendshme te FSHPS. Ne rast te mos zbatimit te kesaj rregullore, KD kerkon pezullimin e perkohshem te anetarit te FSHPS deri ne Asamblene e radhes ku kerkohet heqja e anetaresise.

Anetaret e FSHPS jane te detyruar sipas **Nenit 7** te Statutit te FSHPS te paguajne kuotizacionin vjetor ndaj FSHPS. Vlera e kuotizacionit vjetor vendoset nga KD dhe miratohet nga Asambleja e Pergjithshme.

Kuotizacionet nga FSHPS duhet te paguhen nga te gjitha Klubet Anetare te FSHPS si dhe nga klubet te cilat kane nisur procedurat e anetaresimit brenda muajit Shkurt te cdo viti. Klubet dhe anetaret e FSHPS kane kuotizacion fiks ne rast se klubi perbehet nga 5 deri ne 10 anetare. Ne rast se klubi perbehet me me teper se 10 anetare, vlera e kuotizacionit eshte vlere per cdo anetar te klubit. Sekretari ose Kryetari i klubit dorezon prane Sekretariatit te FSHPS listen e antereve se bashku me vleren e kuotizacionit.

Marrja e statusit Anetar Provizor behet duke paraqitur prane sekretariatit te FSHPS Aktin e Themelimit dhe Statutin e klubit. Pas daljes se vendimit te gjykates klubi ben kerkesen per anetaresim dhe kerkesen e shqyrton dhe e miraton Asambleja e Pergjithshme e FSHPS.

Klubet me status Anetar Provizor te FSHPS kane te drejte te marrin pjese ne te gjitha aktivitetet e organizuara nga FSHPS por nuk mund te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme te FSHPS me te drejte vote. Ata mund te marrin pjese si degjues, mund te marrin pjese ne diskutime por nuk kane te drejte vote. Keto klube jane te detyruar te paguajne kuotizacionin vjetor te FSHPS dhe te zbatojne rregulloren e brendshme te organizimit te FSHPS.

Anetaret e FSHPS dhe Klubet me status Anetar Provizor jane te detyruar qe te kene te pakten **pese** sportiste aktive qe marrin pjese ne aktivitetet sportive te organizuara nga FSHPS pergjate vitit kalendarik te aktiviteve. Ne rast se nje klub nuk paraqet te pakten pese sportiste pergjate gjithe vitit ne aktivitetet e organizuara nga FSHPS, humbet te drejten e anetarit te FSHPS. Ne kete rast KD paraqet ne mbledhjen e radhes te Asamblese kerkesen per heqjen e Anetaresise.

Perdorimi i LOGOS se FSHPS ne veshjet, banerat apo dokumentat zyrtare behet vetem nga Anetaret e FSHPS. Anetaret Provizore nuk kane te drejte perdorimin e LOGOS pa u pranuar me pare si anetar nga Asambleja e Pergjithshme. Ne rast humbje te Anetaresise, perdorimi i logos se FSHPS eshte kategorikisht i ndaluar.

NENI 5 - TEKNIKAT E PESHKIMIT SPORTIV DHE GARAT E ORGANIZUARA NGA FSHPS

Peshkimi sportiv ndahen ne dy kategori:

- 1. Peshkim ne det**
- 2. Peshkim ne ujera te brendshme (Ujerat e embla)**

Peshkim ne det:

1. Peshkim nga bregu me tekniken Surfcasting
2. Peshkim me tape
3. Peshkim nga varka
4. Peshkim me tekniken Feeder
5. Peshkim me imitues

Peshkim ne ujera te brendshme:

- Peshkimi me tape
- Peshkim me tekniken Feeder
- Peshkim me imitues

GARAT E ORGANIZUARA NGA FSHPS

1. Peshkim ne tekniken Surfcasting
2. Peshkim me tape ne det dhe ujera te embla
3. Peshkim me tekniken Feeder ne det dhe ujera te embla
4. Peshkim me imitues ne det dhe ujera te embla
5. Hedhje teknike (Longcasting) ne fushe

TIPOLOGJITE E GARAVE

- 1. Kupa e Shqiperise** – Ne kete tipologji gare mund te marrin pjese dashamires te peshkimit sportiv te cilet mund te mos jene anetare te klubeve anetare te FSHPS. Gjithashtu ne kete tipologji gare mund te marrin pjese edhe shtetas te huaj te cilet mund te jene me banim ne Shqiperi ose jashte. Kupa e Shqiperise ka vetem nje etape dhe zgjat minimumi 6 ore.

2. **Kampioniat Kombetar** – Ne kete tipologji gare marrin pjese vetem anetaret e klubeve te cilat kane nisur procesin e anetaresimit ne FSHPS (Anetar Provizor) dhe anetaret e klubeve anetare te FSHPS. **Pjesemarresit duhet te jene shtetas Shqiptare me pashaporte Shqiptare.** Lista emerore e pjesemarresve ne kampionatin kombetar dorezohet nga klubet brenda dates 10 Mars dhe ne rast se ka shtesa ne pjesemarrje, duhet te dorezohen jo me vone se dy jave para organizimit te gares. Kampionati Kombetar ka **dy deri ne tre** manshe te cilat zgjasin minimumi 5 ore.
3. **Kampioniati Kombetar i Klubeve** – Ne kete tipologji gare marrin pjese antaret e klubeve te cilet mund te jene shtetas shqiptare ose te huaj, me kusht qe me pare duhet te jene te federuar minimalisht 15 dite perpara zhvillimit te gares.
4. **Liga Superiore** – Ne Ligen Superiore marrin pjese **25 sportiste** qe ne renditjen finale te Kampioniatit Kombetar kane dale te paret. Pas vitit te pare te organizimit te Liges Superiore, 5 sportistet te cilet jane renditur te fundit te rezultatin final dalin nga kategoria dhe zevendesohen me 5 sportistet te cilet dalin te paret ne Kampionatin Kombetar pasardhes. Liga Superiore ka 3 ose 4 manshe, nga te cilat dy ose tre ne peshkim dhe nje ne hedhje teknike. Ne rast mungese te sportisteve ne ditën e gares, keta sportiste automatikisht bien nga kategoria dhe zevendesohen me sportistet sipas renditjes ne Kampionatin Kombetar. Konfirmimi i pjesemarrjes ne Ligen Superiore duhet te behet jo me vone se dy jave perpara organizimit te gares.
Dhjetë Sportistet te cilet renditen te paret ne Ligen Superiore perbejne **Ekipin Kombetar** te vitit pasardhes.
5. **Garat Memoriale** – Jane gara te organizuara nga FSHPS per nder te figurave apo ngjarjeve historike. Ne keto gara mund te marrin pjese te gjithë te apasionuarit te peshkimit Sportiv.
6. **Garat e Klubeve** – Keto gara organizohen nga klubet anetare te FSHPS dhe kane detyrim zbatimin e rregulloreve te miratuara nga FSHPS. Klubet jane te detyruara te paraqesin kalendarin e aktiviteteve te tyre brenda nje jave pas miratimit te Kalendarit Zyrtar te aktiviteteve te organizuara nga FSHPS. Te gjitha aktivitetet miratohen nga KD. Garat e organizuara nga klubet jane te detyruara te gjykohen nga gjyqtaret dhe komisaret e garave te cerifikuar nga FSHPS. Garat e organizuara nga klubet nuk duhet te kene mbivendosje me datat e garave te organizuara nga FSHPS. Ne rast se nje klub ka dorezuar kalendarin dhe ka data te njejta me garat e organizuara nga nje klub tjeter, KD ndermjeteson qe te gjendet nje zgjidhje per spostimin dhe rregullimin e kalendarit ne menyre qe te mos kete perplasje.

Rregulloret e garave miratohen nga KD ne varesi te teknikes dhe publikohen ne faqen zyrtare te FSHPS www.fshps.org

NENI 6 – BUXHETI VJETOR I FSHPS

Buxheti vjetor i FSHPS perpilohet nga KD dhe miratohet nga Asambleja e Pergjithshme. Ne projekt buxhet futen te gjitha shpenzimet e mundshme qe mund te duhen per te permbushur nevojat dhe detyrat e FSHPS per funksionimin dhe realizimin e aktiviteteve sportive.

Burimet per buxhetin vjetor te FSHPS jane:

1. Kuotizacionet nga Anetaret e FSHPS
 2. Kuotizacionet nga pjesemarresit ne garat dhe aktivitetet e FSHPS
 3. Shitje e veshjeve eskuzive te FSHPS (kapele, bluza, uniforma etj) ose orendive te tjera
 4. Sponsorizimet
- Per nevojat baze te funksionimit te FSHPS si kostot e mbledhjeve, kancelari, mirembajtje faqe WEB si dhe shpenzime te tjera, buxheti percaktohet dhe merret nga kuotizacionet e Anetaresise.
 - Per organizimin e garave dhe aktiviteteve sportive te organizuara nga FSHPS buxheti percaktohet nga pjesemarrja e garuesve dhe nevoja logjistike per realizimin e gares. Pasi percaktohet vlere e buxhetit te organizimit duke llogaritur te gjitha kostot, kjo vlere pjestohet me numrin e parashikuar te pjesemarresve dhe nxirret kosto e pjesemarrjes. Kuotizacioni per pjesemarrjen ne gare paguhet brenda dates 10 Mars per pjesemarresit ne Kampionat Kombetar ndersa per garat si Kupa e Shqiperise apo gara te tjera memoriale te organizuara nga FSHPS ku pjesemarrja eshte e lire, kuota vendoset nga KD dhe paguhet dy jave para organizimit te gares.
 - KD mund ta shohe te arsyeshme qe per te permbushur nevojat e FSHPS per rritjen e buxhetit vjetor te nxjerre ne shitje produkte eskuzive si uniforma te ekipit kombetar, bluza, kapele apo orendi te tjera. Cmimi i shitjes se tyre vendoset nga KD dhe fitimi i gjeneruar kalon ne buxhetin e FSHPS.

Buxheti i FSHPS administrohet nga Sekretari i Pergjithshem dhe monitorohet nga KD. Pas mbylljes se vitit kalendarik, Sekretari i Pergjithshem paraqet ne Asamblene e Pergjithshme raportin financiar te vitit.

Ne rast se KD verteton abuzim me buxhetin vjetor, i kerkon Asamblese se Pergjithshme shkarkimin e menjehershme te Sekretarit te Pergjithshem si dhe nisjen e procedurave ligjore per demshperblimin e vleres.

NENI 7 – SPONSORIZIMET

Kompanite te cilat duan te promovohen nepermjet shfrytezimit te burimeve te FSHPS sic jane garat sportive apo aktivitetet e tjera te organizuara nga FSHPS duhet ti nenshtrohen rregullave te cilat percaktohen ne kete rregullore. Kompanite mund te sponsorizojne nepermjet vlerave monetare ose nepermjet sherbimeve apo materialeve te cilat mund te sherbejne per nevoja te FSHPS apo per organizimin e nje aktiviteti sportiv.

Sponsoret ndahen ne dy kategori:

1. Sponsor gjeneral
2. Sponsor i thjeshte

Sponsor gjeneral i FSHPS dhe aktiviteve te saj behet ajo kompani qe vleren e sponsorizimit e ben ne shumen mbi 1000 EUR ne vlere monetar apo materiale dhe sherbime te cilat sherbejne per nevojat e FSHPS apo te aktiviteve te organizuara. Logo e sponsorit gjeneral vendoset ne te gjitha materialet e publikuara nga FSHPS per aktivitetin dhe ne website te FSHPS. Gjithashtu logo e sponsorit gjeneral te aktivitetit vendoset edhe ne kupat, bluzat dhe banerat e aktivitetit. Logo e sponsorit gjeneral qendron per nje vit ne website e FSHPS www.fshps.org .

Sponsor i thjeshte i FSHPS dhe aktiviteve te saj mund te behet cdo kompani qe vleren e sponsorizimit e ben nen shumen 1000 EUR ne vlere monetare apo sherbime dhe materiale te cilat sherbejne per nevojat e FSHPS apo aktiviteve te organizuara. Logo e sponsorit te thjeshte vendoset ne banerat e aktivitetit dhe ne materialet e aktivitetit.

KD verifikon vleren e sponsorizimit nese kompania e cila kerkon te sponsorizojte ofron materiale apo sherbime te ndryshme.

KD perpilon kontraten e cila lidh marveshjen midis kompanise dhe FSHPS ku shenohen te drejtat dhe detyrimet e paleve.

NENI 8 – WEBSITE DHE PUBLIKIMET ZYRTARE TE FSHPS

Website zyrtar i FSHPS eshte www.fshps.org. KD cakton nje person pergjegjes i cili kujdeset per mirembajtjen e website dhe per perditesimin e informacionit dhe publikimin e vendimeve dhe rregulloreve qe nxjerr FSHPS. Kosto e mirembajtjes dhe kosto vjetore e domain paguhet nga buxheti vjetor i FSHPS.

Te gjitha publikimet zyrtare te FSHPS behen vetem tek webiste zyrtar i FSHPS.

Gjithashtu FSHPS ka edhe faqet zyrtare ne rrjetet sociale si Facebook, Instagram, Youtube etj. te cilat sherbejne vetem per publikimet qe lidhen me aktivitetet e organizuara nga FSHPS si foto, video apo reportazhe te ndryshme.

NENI 9 – ZBATUESHMERIA E RREGULLORES

Kjo rregullore hartohet nga KD dhe miratohet nga KD. Zbatueshmeria e kesaj rregullore eshte detyrim per te gjithe anetaret e FSHPS. Ne rast mos zbatimi te kesaj rregullore nga anetaret e FSHPS , KD kerkon ne mbledhjen e radhes se Asamblese se Pergjithshme heqjen e anetaresise.

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere.

Miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHPS

Tirane, 17 Janar 2024